



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 442 prot.

Elbasan, më 27.4.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr. 33 dt.29.03.2024 “Për caktim agjenti tatimor për vitin 2024”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI



Majlinda PERRIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.03.04.2024

Nr. 1626/19 prot

Nr.33 dt.29.03.2024

“PER CAKTIM AGJENTI TATIMOR PER VITIN 2024”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit 9632 datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar me Ligjin nr.106/2017, date 30.11.2017, VKM Nr. 132 , date 07.03.2018" Për Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të Pasurisë së Paluajtshme "Ndertesë " e bazës së taksës për kategori specifike", VKB nr 108 date 30.11.2023 “ Per Miratimin e taksave dhe tarifave Vendore per Vitin 2024” Këshilli Bashkiak I mbledhur sot më date 29.03.2024 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

- 1- Të miratojë Agjent Tatimor Sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Sh.a Elbasan për vjeljen e tarifës së pastrimit, taksës së ndërtesës, tarifës së gjelbërimit, tarifës së ndricimit, tarifave të tjera të abonentëve familjare për vitin 2024.
- 2- Masa e shpërblimit të agjentit tatimor për tarifatat do të jetë 1 % e vlerës së arkëtuar.
- 3- Vjelja e detyrimit të pasqyrohet në faturën tatimore, detyrimi për cdo familje do të përpjestohet në muaj sipas marreveshjes që do të lidhet me ujesjiellesin .
- 4- Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e të Ardhurave Vendore ,Bashkia Librazhd .
- 5- Ky urdher hyn në fuqi më 10 ditësh nga dalja e Vendimit të Këshillit Bashkiak.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT
Silvana HOXHA

